



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:174484

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05587770

C.nr.284/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Zenel Tasholli, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësve I. A.-M. dhe E. S. që të dy nga L., të cilët i përfaqëson Avokatura MBN Sh.P.K. me seli në Prishtinë, me përfaqësues avokatët Mexhid Sylja, Blerim Sylja dhe Nexhat Sylja, kundër të paditurës K. e S. “S.” me seli në P., për kompensim dëmi, duke vendosur përkitazi me parashtresën e të autorizuarit të paditësve të dt. 16.04.2024, për tërheqjen e padisë, me dt. 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET SE padia** e paditësve I. A. – M. dhe E. S., që të dy nga Lipjani, kundër të paditurës K. e S. “S.” me seli në P., për zhdëmtim, është **TËRHEQUR**.
- II. **OBLIGOHEN** paditësit që në emër të taksës gjyqësore të paguajnë shumën prej 40.00€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve me parashtresën të cilën në gjykatë e ka dorëzuar me dt.16.04.2024, e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës në këtë çështje juridiko-civile, me arsyetim se palët kanë arritur marrëveshje për kompensimin e dëmit në procedurë jashtëgjyqësore.

Me dispozitën e nenit 261 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së parashihet “paditësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurëve deri në momentin në të cilin të paditurit e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi” dhe “padia mund të tërhiqet edhe më vonë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor në qoftëse i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po qe se i padituri brenda 7 ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261, par.1 dhe 2, e lidhur me nenin 387.1 pika C të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga të theksuarat më lartë, gjykata vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.284/15, me dt. 18.04.2024.

GJYQTARI
Zenel Tasholli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.